



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

## AUTORITETI I KONKURENCËS

### VENDIM

Nr. 879, Datë 15.04.2022

**“Për  
rrezimin e kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për revokimin e Vendimit nr.  
874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja d), neni 26, neni 46 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003);

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për anulimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, si dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

### VËREN SE:

1. Ndërmarrja ÇAÇA SHPK me anë të shkresës së saj të datës 04.04.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 204/1 prot, dt. 06.04.2022), me lëndë “Kundërshtim i vendimit nr. 874, datë 25.03.2022”, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës anulimin e vendimit nr. 874, datë 25.03.2022, për gjobën në shumën prej 7,087,994 lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c) të ligjit nr. 9121/2003, duke paraqitur dhe argumentet mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj.
2. Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes ÇAÇA SHPK dhe argumentet e paraqitura prej saj, argumente këto të cilat janë parashtruar nga ana e kësaj ndërmarrjeje edhe para marrjes së vendimit përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 objekt ankimi, duke mos paraqitur fakte dhe të dhëna shtesë lidhur me këtë vendimmarrje.

3. Bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
4. Në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, procedura administrative e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure ka përfunduar me marrjen e vendimit administrativ përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, vendim i cili, në respektim të nenit 79 të ligjit nr. 9121/2003, mund të ankimohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.
5. Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.
6. Në respektim të këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
  - a) Njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
  - b) Palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
  - c) Vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
7. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes ÇAÇA SHPK nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), dhe nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- I. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes ÇAÇA SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

- II. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes ÇAÇA SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**